



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.404/11 prot.

Datë 02.03.2026

V E N D I M
Nr. 323/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.282/2026, datë 19.02.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-72602-12-17-2025, me objekt: “Loti 1 Isoflurane Inhalation vapour, Liquid x 100 ml Flakon”, me fond limit 3,978,635.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 19.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara

Ankimues: “Vitanet Albania” SHPK me NIPT K92201080V dhe adresë: *Rr. Njesia Bashkiake nr 8, Rruga Siri Kodra, ndertese 2-kateshe, me zone kadastrale 8340 dhe nr pasurie 8/660, kati 1, Tirane*

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: *Rruga “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)*

Subjekte të Interesuara: “Medicamenta” SHPK me NIPT K41420001V dhe adresë: *Tiranë, Kashar, Autostrada Tirane Durres, Km 6, Ndertesa dy kateshe nr. 5, kati i I i nderteses, prane Poseidon*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit

Publik”, Neni 4, i Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 19.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.282/2026, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vitanet Albania” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-72602-12-17-2025, me objekt: “Loti 1 Isoflurane Inhalation vapour, Liquid x 100 ml Flakon”, me fond limit 3,978,635.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 19.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e KSHA-së me nr. 22/2026 datë 17.02.2026 të ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike përmes shkresës me nr. 4283/32 prot., datë 17.02.2026 protokolluar me tonën me nr. 404/2 prot., datë 17.02.2026.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP mbi zbatimin e vendimit të KSHA duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimes “Vitanet Albania” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.4283/40 prot., datë 25.02.2026, dërguar përmes komunikimit elektronik zyrtar e cila u protokollua me tonën me nr.404/8 prot., datë 27.02.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 282/2026 datë 19.02.2026 duke i bashkëngjitur shkresës edhe procesverbalin e datës 25.02.2026 për rivlerësimin e procedurës.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.4283/40 prot., datë 25.02.2026, dërguar përmes komunikimit elektronik zyrtar e cila u protokollua me tonën me nr.404/8 prot., datë 27.02.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 282/2026 datë 19.02.2026 duke i bashkëngjitur shkresës edhe procesverbalin e datës 25.02.2026 për rivlerësimin e procedurës.

II.2. Nga verifikimi në seksionin “Hetim” në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe dokumentacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik duke skualifikuar operatorin ekonomik “Medicamenta” SHPK në përputhje me vendimin e KSHA-së me nr. 22/2026 datë 17.02.2026 të ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike përmes shkresës me nr. 4283/32 prot., datë 17.02.2026 protokolluar me tonën me nr. 404/2 prot., datë 17.02.2026, në bazë të të cilit sipas parashikimeve të nenit 115 të LPP-së, KPP me vendimin nr.282/2026, datë 19.02.2026 ka mbyllur çështjen.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor, ka zbatuar vendimin e KSHA-së me nr. 22/2026 datë 17.02.2026 të ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike përmes shkresës me nr. 4283/32 prot., datë 17.02.2026 protokolluar me tonën me nr. 404/2 prot., datë 17.02.2026, për të cilin sipas parashikimeve të nenit 115 të LPP-së, KPP me vendimin nr.1641/2024, datë 19.11.2024 ka mbyllur çështjen për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-72602-12-17-2025, me objekt: “Loti 1 Isoflurane Inhalation vapour, Liquid x 100 ml Flakon”, me fond limit 3,978,635.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 19.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-72602-12-17-2025, me objekt: “Loti 1 Isoflurane Inhalation vapour, Liquid x 100 ml Flakon”, me fond limit 3,978,635.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 19.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	Anëtar	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anila Malaj	Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

